REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 855 Prot. Tiranë, më 24.7.2018

**VENDIM Nr. 142, datë 18.07.2018**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 134,* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 7, datë 18.07.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër *të projektit "HEC KUÇ, mbi përroin Shuri i Kuçit" Vlorë*-subjekti "AGE KUÇ" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji " K.A.E.XH." sh.p.k.,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër ***të projektit "HEC KUÇ, mbi përroin Shuri i Kuçit" Vlorë***-subjekti "AGE KUÇ" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji " K.A.E.XH." sh.p.k.

2. Subjekti "AGE KUÇ" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "HEC KUÇ, mbi përroin Shuri i Kuçit" Vlorë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.

3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë
Tel: ++355 04 45 35 855
email: *sekretaria.kka@asha.gov.al*
Website: asha.gov.al

5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë
Tel: ++355 04 45 35 855
email: ***sekretaria.kka@asha.gov.al***
Website: asha.gov.al